



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИСË СË

Бр./Nr \_\_\_\_\_

г./в. \_\_\_\_\_



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 97-të të mbajtur më 27.12.2023, ka miratuar sa vijon,

## VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-3359/1, datë 29.09.2020, kundër /// të /// dhe /// të ///, në momentin e dorëzimit të kërkesës – gjyqtarë të Gjykatës Themelore në ///, dhe kundër ///, /// dhe ///, në momentin e dorëzimit të denoncimit – anëtarë në këshillin gjykues pranë Gjykatës së Apelit në ///, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Lënda me numër 12-3359/1 nga 29.09.2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

## Arsyetim

Më datë 29.09.2020, një parashtrues i panjohur ka bërë denoncim kundër /// nga /// dhe /// nga ///, në momentin e dorëzimit të denoncimit – gjyqtarë të Gjykatës Themelore në ///, dhe kundër ///, /// dhe ///, në momentin e dorëzimit të denoncimit – anëtarët e këshillit gjykues pranë Gjykatës së Apelit në ///, dhe është formuar lënda me nr. 12-3359/1, datë 29.09.2020.

Në denoncim, parashtruesi pretendon sjellje të njëanshme dhe joprofesionale të gjyqtarëve të Gjykatës Themelore /// në proceset pas një padie të ngritur nga pronarët e apartamenteve në një ndërtesë banimi kolektive në rrugën /// në ///, kundër pronarëve të tokës ndërtimore në bazë të trashëgimisë dhe kundër blerësit të një pjese ideale të tokës ndërtimore, me kërkesë në të cilën kërkohet të vendoset e drejta e pronësisë së përbashkët mbi pjesët e përbashkëta dhe e drejta e bashkëpronësisë mbi ndërtimin në tokën nën pallat dhe oborr.

Sipas asaj që është paraqitur në denoncim, gjyqtarët e Gjykatës Themelore /// kanë marrë një vendim që ka ndryshuar vlerën e mosmarrëveshjes, ndërsa vendimi nuk u është dorëzuar të pandehurve, gjë që i ka penguar ata të bëjnë ankim. Po kështu, parashtruesit e kërkesës në KSHPK mendojnë se është tregues i sjelljes tendencioze të gjyqtarëve. Në të njëjtën

Адреса: ул. Пресвета Богородица број 3, 1000 Скопје - Република Северна Македонија  
Adresa: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut

email: [contact@dksk.org.mk](mailto:contact@dksk.org.mk)

тел/tel: +389 2 3248 930

<http://www.dksk.mk>

kohë, kërkuesit paraqesin pretendime për selektivitet në vlerësimin e provave. Gjithashtu, parashtrajnë pretendime se edhe gjatë rigjykimit, me përbërje të ndryshuar të gjyqtarëve, pas anulimit të aktgjykimit të shkallës së parë pas ankesës, gjykata e shkallës së parë ka marrë të njëjtin vendim, pa marrë parasysh udhëzimet nga Gjykata e shkallës së dytë dhe Gjykata e Apelit /// e ka vërtetuar me aktgjykim një vendim të tillë.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja ka konstatuar bëhet fjalë për pretendime që nuk janë objekt i veprimit të saj kompetent.

Duke marrë parasysh se pretendimet nga denoncimi i referohen vendimeve gjyqësore që KSHPK-ja nuk ka kompetencë t'i shqyrtojë, si dhe faktin se në denoncim nuk ka pretendime konkrete për veprime korruptive, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Për sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përgatiti: A.R.M.

Miratoi: S.P.D, anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËROR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
Nënkryetar,  
Sofka Pejovska Dojçinovska**